

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KËSHILLIN E QARKUT DIBËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Këshillin e Qarkut Dibër**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.09.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 41, datë 30.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.161/6, datë 30.04.2014, i ka rekomanduar z. Naim Gazidede, Kryetar i Këshillit të Qarkut Dibër, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASAT ORGANIZATIVE

1. Të merren masa në lidhje me zbatimin e procedurave në ngritjen e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar në përputhje me kërkesat e ligjit nr 6296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr. 6082, datë 16.03.2011 “*Mbi hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike mbi impletimin e këtij ligji*”.

Menjëherë

2. Drejtoria e Zhvillimit dhe Projektimit, gjatë hartimit dhe miratimit të buxheteve vjetore, për transferimin e këtyre fondeve nga ky institucion në njësitë e qeverisjes vendore, të kërkojë nga këto njësi përveç kërkesës për fonde edhe projektet e zbatimit të shoqëruara me preventivat përkatës.

Vazhdimisht

3. Për të gjithë prokurimet me vlerë të vogël të parashikuar në buxhetet vjetore, për blerje mallrash apo kryerje shërbimesh, të dërgohet pranë APP-së dhe Rregjistri i Parashikimit dhe Realizimit të tyre, kërkesë kjo e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”.

Vazhdimisht

4. Në prokurimet që do të zhvillohen në të ardhmen, nga ana e titullarit të Autoritetit Kontraktor, ose personit të autorizuar prej tij të sigurohet një ndarje e qartë e detyrave ndërmjet punonjësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, në kundërshtim me shkronjën “a”, pika 1, të kreut V-të, të VKM nr 1, datë 10.01.2007, të ndryshuar.

Vazhdimisht

5. Dokumentat e tenderit të plotësohen me të gjithë dokumentacion e nevojshëm me qëllim llogaritjen sa më të saktë të vlerës së kontratës dhe argumentimin e fondit limit, me specifike teknike të sakta, duke bërë sqarimet e nevojshme me shkrim dhe të analizohen kostot e mallit “Gazoil”, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9743, 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2006, i ndryshuar, Kreu II, pika 2/a, c, ç.

Vazhdimisht

6. Në prokurimet e punëve publike, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë të pranohen vetëm kur janë të shoqëruara me analizat tekniko-financiare të punimeve, konforme Dokumentave Standarte të Tenderit (DST), Kap. 3 “*Udhëzime për operatorët ekonomikë*”, paragrafi 3.12, “*Llogaritja e çmimit*”.

Vazhdimisht

7. Kontratat me operatorët ekonomikë fitues të lidhen sipas formularit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, sipas “*Kushteve të Përgjithshme*” dhe “*Kushtet të veçanta*” të kontratës dhe në kontratë të përfshihen çmimi dhe vlefata e kontratës dhe jo vetëm marzhi i fitimit, sipas Dokumentave Standarte të Tenderit.

Vazhdimisht

8. Nga autoriteti i planifikimit Këshilli i Qarkut Dibër të mos miratohet asnjë leje zhvillimi në mungesë të planifikimit vendor të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), dhe lejet të jepen vetëm në tokë “Truall”, sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

9. Nga Këshilli i Qarkut Dibër, të inventarizohen dhe arkivohen dosjet e prokurimit, të lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit (shtrytëzimit), sipas ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Deri më datë 30.07.2014

10. Inspektoriati të Mbrojtjes së Tokës, në të ardhmen, të zbatojë programet vjetore, nëpërmjet realizimit të kontrolleve metodikë dhe operative, të mbahet regjistri i mbrojtjes së tokës dhe dokumente të tjera, ku të evidentoheshin treguesit thelbësorë për gjendjen dhe masat mbrojtëse për tokën bujqësore dhe të paraqiten raporte përmbledhës për Kryetarin e Komisionit të Tokës në Qark, sipas ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 dhe VKM nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”.

Vazhdimisht

11. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV), në të ardhmen të rrisë cilësinë dhe performancën e punës së vet, si në drejtim të eficiencës dhe të procedohet me masa administrative, si gjoha dhe prishje të ndërtimeve të kundërligjshme e kallëzime penale, bazuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.2009 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.02.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV – Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues) të nxirren aktet administrative me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,269,837 lekë**:

1.Vlera 708,818 lekë, në ngarkim të 8 punonjësve për paga të dhëna në kundërshtim me lidhjen 3 dhe 6 si dhe pikën 18 të VKM nr.1619, datë 02.06.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufirit të pagave të organeve të qeverisjes vendore”.

Deri më 30.06.2014

2.Vlera 543,819 lekë, në ngarkim të 12 punonjësve për përballimin nga artikulli 602 të shpenzimit të telefonisë së lëvizshme, në kundërshtim me kërkesat e pikës 11, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen më numër telefoni celular të personave juridik-publik”.

Deri më 30.06.2014

3.Vlera 17,200 lekë, në ngarkim të 10 subjekteve ndërtues ose investitorëve, për dhënie leje përdorimi në kushtet e mospagesës së tarifave për kontrollet e piketimit të objektit dhe të sistemimit të jashtëm, si rezultat i moshartimit të akteve të kontrollit për fazat e ndërtimit të objektit, bazuar në Vendimin e KQ Dibër nr. 27, datë 21.06.2007.

Deri më 30.08.2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkohet të fillojmë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

I. “Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, gërma a

1.Për Z.M. dhe

2.Për A.Z. me detyrë ish-drejtorë të Urbanistikës, aktualisht specialistë në Këshillin e Qarkut Dibër, pasi:

-Kanw lejuar të jepen leje përdorimi, në sheshe ndërtimi me zërin kadastral “Tokë arë”, si dhe mungesa në dokumentacionin e kërkuar, sidomos moshartimi i akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit dhe mosvjelja e tarifave, duke shkaktuar një dëm ekonomik 8,600 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe në Vendimin e KQ Dibër nr. 27, datë 21.06.2007, në 7 raste (5+2).

II. “Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, gërma b

1. Për Z.M. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Personelit dhe Administratës, për periudhën 2008 deri në muajin Prill 2013, aktualisht specialist në Këshillin e Qarkut Dibër, *pasi*:

- Ka lejuar të paguhen padrejtësisht 6 punonjës, duke shkaktuar një dëm ekonomik në Buxhetin e Këshillit Qarkut Dibër, për vlerën 708,818 lekë, në kundërshtim me lidhjen nr. 3 “Niveli i pagave për nënpunësin civil, në Këshillin e Qarkut”, me lidhjen nr 6 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, të VKM nr. 553, datë 11.08.2011 të VKM nr. 518, datë 16.08.2012 Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore”.

2. Për F.F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, për periudhën 18.07.2012 e në vazhdim, *pasi*:

-Ka lejuar të paguhen padrejtësisht 6 punonjës, duke shkaktuar një dëm ekonomik në Buxhetin e Këshillit Qarkut Dibër, për vlerën 708,818 lekë, në kundërshtim me lidhjen nr. 3 “Niveli i pagave për nënpunësin civil, në Këshillin e Qarkut”, me lidhjen nr 6 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, të VKM nr. 553, datë 11.08.2011 të VKM nr. 518, datë 16.08.2012 Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

- Ka lejuar të përballohen nga artikulli 602 “Shpenzime operative”, shpenzimet e kryera për telefoninë e lëvizshme të 12 punonjësve të këtij institucioni, duke shkaktuar një dëm ekonomik në Buxhetin e Këshillit Qarkut Dibër për vlerën 543,819, në kundërshtim me kërkesat e pikës 11, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen më numër telefoni celular të personave juridik-publik”.

Nga Këshilli i Qarkut Dibër me shkresë nr.196/3, prot, datë19.05.2014, protokolluar në KLSH me nr.161/7 datë 21.05.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Ramadan Zejnuni dhe Aleksandër Papadhimitri, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT